




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Dpj.
Dep.	Dpj.
Dep.	Dpj.
Nr. fletë	DPK/DPK/
Broj stranica	03
Nr. pages	
Nr. Prot.	
Nr. Prot.	
Prot No 03-02780/17	
Data	
Datum	
Date 16-01-2017	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.01.2017, mori:

V E N D I M

I, Myllet rasti me nr. AKK-03-02-4124/16, për zyrtaren e lartë znj. Serbeze Kabashi-Muçaj, Drejtore e Klinikes se Radiologjisë-QKUK, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë ekzistimin e konfliktit të interesit në rastin e përgjedhjes për pozitat mjek-specialist në konkursin e zhvilluar në QKUK-SHSKUK.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Pas kërkesës se pranuar në AKK-ë nga një palë e tretë ku pretendohej se ka konflikt të interesit ne mes të kryetares së komisionit vlerësues në konkursin e datës 31 Mars 2016, të shpallur nga ana e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për 17 pozita mjek-specialist, ne mes të Serbeze Kabashi-Muçaj, Drejtore e Klinikes se Radiologjisë dhe kandidates se pranuar në pozitën specialistë e Oftalmologjis znj. Mimoza Ismaili, pasi qe të dyja punojnë bashkë në poliklinike private “Neoromedica” në Podujevë.

AKK-sipas procedurave ka nxjerr vendimin me nr.AKK-03-02-4124/16 për fillimin e shqyrtimit të situatës së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtaren e lartë, dhe ka zhvilluar procedurën e paraparë duke njofuar zyrtaren për fillimin e procedurës për trajtim të situatës se mundshme të konfliktit të Interesit. AKK, e ka ftuar zyrtaren në takim informues për të marrë informata shtesë dhe për ta informuar lidhur me çështjen ngritur, gjatë takimit i cili është mbajtur në zyrat e AKK-së, zyrtarja e lartë znj. Serbeze Kabashi-Muçaj, është pyetur lidhur me konkursin publik të datës 01.04.2016 ne SHSKUK/QKUK, si dhe raportet me njëren nga aplikueset ne ketë konkurs

zpj. Mimoza Ismaili e cila është përgjedhur për vendin e punës specialist Oftalmolog, si dhe a punojnë se bashku me zpj. Mimoza Ismaili në polikliniken private “Neoromedica” në Podujevë.

Duke u përgjigjur pyetjeve tona në ketë takim zpj. Serbeze Kabashi-Muçaj na ka njoftuar për konkursin në pika te shkurta duke theksuar se komisioni për përgjedhjen e mjekeve specialist e ka bër vlerësimin duke u bazuar në kriteret dhe aftësitë qe kanë pasur kandidatet ndërsa ka deklaruar se me zpj. Mimoza Ismaili nuk ka asnjë raport për veç qe raporteve kolegiale siç janë me shumicën e aplikantëve në ketë konkurs, zpj. Kabashi ka theksuar se nuk punon në poliklinikën private “Neoromedica” në Podujevë, dhe as një herë nuk kanë punuar se bashku me zpj. Mimoza Ismaili, ne ketë klinikë kam qene si staf i paraqitur por kam shkuan vetëm një herë për konsulta të pacienteve ne vitin 2013, pasi qe kjo klinikë ka pasur defekte me aparaturën radiologjike dhe nuk kemi mundur të vazhdojmë me, ndërsa në vitin 2015 kam kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që të me mundësoj tërheqjen e licencës nga poliklinika “Neoromedica” në Podujevë, pasi qe ka kohë qe nuk jam e angazhuar në ketë institucion shëndetësor. zpj. Serbeze Kabashi-Muçaj ka deklaruar ne fund se nuk ka konsideruar dhe as konsideron se mund të ketë konfliktit të interesit me as njërin nga pjesëmarrësit e Konkursit për përgjedhjen e mjekëve specialist të lemive të ndryshme në QKUK- të datës 31.03.2016 pasi qe me asnjërin nuk kam lidhje afërsie apo interes, ajo ka deklaruar se do sjell edhe dëshmi nga poliklinika private “Neoromedica” në Podujevë se ne cilën përudhë ka qen për konsultë me pacient në ketë Poliklinikë.

Agjencia kundër Korruptionit duke zgjeruar hetimet lidhur me ketë rast ka kontaktuar me menaxhmentin e poliklinikës private “Neoromedica” në Podujevë, dhe ka kërkuar nga ta qe ti ofroj informacione zyrtare për zpj. Serbeze Kabashi-Muçaj, se a është e punësuar ne poliklinikën private “Neoromedica” dhe në çfarë cilësie, po ashtu ka kërkuar informata edhe për zpj. Mimoza Ismaili, se a punon ne poliklinikën “Neoromedica” dhe ne çfarë cilësie, pasi qe emrat e tyre figurojnë ne Ueb-faqen e poliklinikës private “Neoromedica” ne Podujevë.

Nga poliklinika private “Neoromedica” kemi pranuar dokumentin zyrtar me nr.Prot.03-02/4747/16- ku na njoftojnë se: zpj. Serbeze Kabashi –Muçaj me profesion radiologe, nuk ka punuar dhe nuk punon ne kliniken tonë “Neoromedica”, me datën 13.02.2013 ka qen për konsultim të pacienteve tanë (7 pacient) por pasi kemi pasur defekte me aparaturën radiologjike nuk kemi mundur te vazhdojmë punën, emri i saj ka mbet ne faqen zyrtare pasi qe nuk është freskuar apo fshirë nga IT.

Ndërsa zpj. Mimoza Ismaili-punon në qendrën tonë ne cilësinë e mjekes-specialiste e Oftalmologjisë qe nga data 01.08.2014 dhe vazhdon të punoj ende.

Bazuar në informatat zyrtare të ofruara nga Poliklinika private “Neoromedica” në Podujevë, rrjedh se zpj. Serbeze Kabashi-Muçaj, Drejtore e Klinikes se Radiologjisë dhe kryesuese e komisionit vlerësues për përgjedhjen e mjekeve specialist të lëmive të ndryshme ne QKUK-ë sipas konkursit publik të datës 31.03.2016 dhe kandidatja e pranuar ne pozitën specialiste e Oftalmologjis zpj. Mimoza Ismaili, nuk punojnë dhe nuk kanë punuar bashkë në polikliniken private “Neoromedica” në Podujevë, ndërsa në bazë të dokumenteve përcjellëse të lendes nuk kemi vërejtur se të njëjtat kanë pasur ndonjë lidhje apo interes të përbashkët që mund të cilësohet si konflikt i interesit të paraparë sipas Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nr.04/L-051.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nr.04/L-051, ka për qëllim të parandalojë konfliktin e interesit të zyrtarët e lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik. Ekzistojnë dispozita të veçanta të cilat rregullojnë situata të ndryshme e që për qëllim kanë parandalimin e konfliktit të interesit, që është masë për parandalimin e korrupsionit. Duke vlerësuar provat dhe faktet qe kemi pasur ne dispozicion lidhur me ketë rast mund të themi se nuk kemi elemente të gjendjes faktike të konfliktit të interesit të paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtori i DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

